



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 208/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 28.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) A.nr.208/2025 e datës 26.01.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datën 26.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendohet se me 26 Janar 2025, përkundër vendimit të PZAP Anr.87/2025 përmes të cilit vendosja e posterëve/banereve të kandidateve për deputetë nga radhët e PDK-së në hapësirat/rrugët publike të Prishtinës i ka vendosur dhe vlerësuar si në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LPZ-së, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë me datë 26.01.2025 kanë identifikuar se banerët/posterët e vendosura në hapësirat publike të kandidateve të shumtë të PDK-së, për deputetë, vazhdojnë të jenë aktive të postuara në hapësirat publike.

Sipas parashtruesit të ankesës PZAP me Vendimin Anr.87/2025 të datës 24 Janar 2025 kishte përfshirë dhe trajtuar ankesat si në vijm:Anr.87/2025, Anr.110/2025, Anr.111/2025, Anr.112/2025, Anr.113/2025 dhe Anr.114/2025 ndaj kandidateve për deputet nga radhët e PDK-së si :Bedri Hamza, Eliza Hoxha, Bernard Nika, Memli Krasniqi, Mimoza Ahmetaj, Ilirik Musliu, Pleurat Sejdiu,Ferat Shala, Ariana Musliu Shoshi, Vlora Çitaku,Uran Ismaili si dhe kandidatë të tjerë, të cilët në hapësirat e ndryshme publike në rrugët: “Nëna Terezë”,

“Fehmi Lladrovci”, Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, “Idriz Seferi”, “Luan Haradinaj”. “Migjeni” e të tjera në Prishtinë kishin vendosur posterët/banerët e tillë.

Parashtruesi i ankesës po ashtu ka theksuar se kjo çështje nuk i përmbush elementet e parimit të çështjes së gjykuar res iudicata dhe secili vendim tjetër i PZAP konsiderohet se është në shpërputhje me parimin e barazisë para ligjit, korrektësisë dhe parimin e drejtësisë duke ditur se elementi material (me anë të dënimit/gjobës së vendosur, pa përmisimin e masave të caktuara) i mbivendoset parimit të barazisë ,drejtësisë, paparashkushmerisë e cila dëmton rendë garën e barabartë elektorale.

Si provë ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerëve/Posterëve në kundërshtim me LPZ si dhe Foto dhe Linku i Vendimit të PZAP Anr.87/2025.

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 28.01.2025 në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të parashtruar në PZAP me datën 28.01.2025 subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar nga PZAP që ta refuzoj ankesën e ankuesit si të pabazuar se PDK me datë 25.01.2025 ndaj vendimit Anr.87/2025 të datës 24 janar 2025 ka parashtruar aneksë pranë Gjykatës Supreme duke theksuar se vendimi i kontestuar është rezultat i konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, andaj parashtrimi i ankesës e pranë Gjykatës Supreme të Kosovës ka efekt suspensiv dhe parashtrimi i një ankese sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën dhe përderisa PDK ende nuk ka pranuar ndonjë vendim më të cilin është zgjidhur ankesa konsiderojmë se vendimi Anr.87/2025 ende nuk prodhon efekte juridike.

Sipas parashtruesit të përgjigjies në ankesë në Rregulloren për Procedurat e Parashtrimit dhe vendosjes të Ankesave përcaktohet se vendimi i PZAP merr formë të prerë brenda 48 orëve, nëse nga momenti i dorëzimit të vendimit nuk dorëzon ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës e që në rastin konkret PDK ka paraqit ankesë ndaj këtij vendimi dhe rrjedhimisht vendimi A.nr 87/2025 nuk ka marr formën e prerë.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur si prova: Ankesën ndaj vendimit Anr.87/2025 si dhe fletë dëshminë për dorëzimin e ankesës në Postën e Kosovës.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën Anr.87/2025 të paraqitur me datën 21.01.2025 nga po i njëjti subjekt politik LVV, kundër të njëjtit subjekt politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, përkatësisht kandidatëve për deputet Eliza Hoxha, Bernard Nikaj dhe kandidatit me numër 50 në listën e PDK-së, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.87/2025 të datës 24.01.2025, Partisë


Demokratike të Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 10,500.00 (dhjetëmijë e pesëqind) euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.87/2025 të datës 24.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesë, pasi që në baze të nenit 101 të LPA-se *“Kërkesa e përsëritur 1.1 nenparagrafi 1.2 Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: një procedurë administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar”*. Andaj, duke marrë parasysh se në bazë të shkresave të lendes dëshmohet se proceduara e zhvilluar për lëndën Anr.87/25, e cila është e njëjte me këtë rast, ende është në pritje të shqyrtimi për ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, Paneli ka vendosur se ankesa e ankuesi është e palejueshme.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115.1 dhe 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 208/2025 më datën 28.01.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardhiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.